

STATUT
I
SHOQËRISË TREGTARE
"PEGASUS OIL TRADING" sh.p.k.

Në Tiranë më datë 21 Maj 2020 (dymijë e njetzet) ditën e Enjete para meje u paraqitën personalisht:

Z.VINCENT,ARA FABRE i biri i Roger dhe Claire lindur në Monte Karlo, Monako ,më 05.05.1971 banues në Monako, Rr 8 Gastaldi 98000MC , i identifikuar me Pasaportën Franceze me Nr. 11CF99964

I lartpërmenduri është madhorë me zotësi të plotë juridike për të vepruar të cilët deklaruan se nuk e kuptojnë gjuhën shqipe dhe asistohen prej meje **KRISTIANA ABOUD** në gjuhën angleze dhe me vullnetin e tyre të lirë e të plotë kanë vendosur të krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin.

Neni 1

EMËRTIMI DHE QENDRA E SHOQËRISË

EMËRTIMI : "PEGASUS OIL TRADING" sh.p.k

SELIA Rruga : "FATMIR HOXHA , PALLATI ETC KULLA A KATI 6/3."—

Shoqëria do të jetë person juridik me regjistrimin në QKB sipas nenit 22 të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" dhe në bazë të Ligjit Nr 9901 të datës 14.04.2008 "PËR TREGËTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE". Shoqëria do të gëzojë të gjithë të drejtat si person juridik dhe do të fillojë veprimtarinë e saj nga data e regjistrimit në QKB.—

Shoqëria e ka selinë e saj në Tiranë, me adresë: Tiranë, Rruga "Fatmir Hoxha,Pallati ETC kulla A Kati 6/3". Ajo mund të çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe me miratim të organeve kompetente edhe jashtë vendit.—

Neni 2

QËLLIMI I SHOQËRISË

Objekti i veprimtarisë së saj do të jetë:

- Ndermjetesimi ne sektorin e energjise , si eshte Kategoria e Naftes dhe Gazit, si dhe cdo neneprodukt qe vjen nga perpunimi i tyre ose dhe jo, pa kufizuar cdo nenprodukt qe vjen nga kto dy kategori.
- Ndermjetesimin dhe zhvillimin e energjise ekologjike ,perberesi bio , energji alternative jo fosile, si dhe kto projekte ne lidhje me kto produkte.
- Marrjen me qera depozitave per magazinime te ktyre produkteve , mirembajtjen dhe shpendarjen e tyre.



- Zhvillimin e projekteve te ndryshme ne fushen e gazit dhe hidrokarbureve brenda dhe jashte vendit ne lidhje me impiante perpunimi ,naftsjelles,transport te naftes dhe gazit.
- Ofrim Sherbimesh , Asistence teknike dhe menaxhimi organizativ dhe tregtar te ndermarrjeveqe veprojn ne sektorin e mesiperm.

Dhe ne pergjithesi cdo veprim ne natyre juridike dhe financjare,industriale ,publike ose tregtare ,prona te palujtshme ose te luajtshme ,te gjitha keto te cilat lidhen me objektin e shoqerise ose me te tjera te cilat jan te ngjashme ose te peraferta dhe ndihmojn direkt ose indirekt ne objektin e shoqerise, ne shtrirjen dhe zhvillimin e saj.

Si objekt te veprimtarise se saj shoqeria do te ketë edhe kryerjen e cdo operacioni ekonomik dhe juridik te lejuar nga legjislacioni Shqiptar , ne perputhje me objektin e veprimtarise se saj dhe qe kane rendesi per te ardhmen e shoqerise.

Neni 3

REGJIMI JURIDIK I SHOQËRISË

“Shoqëria”, në veprimtarinë e saj bazohet në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Kjo shoqëri tregëtare krijohet me objektivin për të vazhduar veprimtarinë për një periudhë kohore pa afat.—

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, mund të ndryshojë rregjimin juridik të Shoqërisë, në qoftë se në të ardhmen krijohen premisa më të favorshme për funksionimin e saj sipas Legjislacionit Shqiptar.—

Në këtë rast Ortakët do ta përshtasin “Kontratën e Themelimit” dhe “Statutin e Shoqërisë”, si dhe regjistrimin e tyre nga organet kompetente Shqiptare.

“Shoqëria” gëzon personalitet juridik nga dita e miratimit dhe e regjistrimit të saj në regjistrin tregëtar në Q.K.B. “Shoqëria” mund të ketë pasuri të luajtëshme dhe të paluajtëshme, në përputhje me dispozitat e Legjislacionit Shqiptar. Pasuria mbrohet sipas dispozitave të ligjit në fuqi.—

“Shoqëria” do të ketë vulën e saj të cilën do ta caktojë me Vendimin e Asamblesë së Ortakëve.—

Neni 4

TË DREJTA DHE DETYRIME

“Shoqëria” ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj. “Shoqëria” gëzon të drejtën që të bëjë importimin dhe eksportime të nevojshme për realizimin e qëllimeve të saj pa asnjë pengesë. Ajo gëzon të drejtën e caktimit të çmimeve dhe të produkteve të saj që do të disponojë për tregun e brendshëm dhe të jashtëm sipas rregullave të Legjislacionit në fuqi. “Shoqëria” ka të drejtën e vënies (rëndimit) në Hipotekë të pasurisë së saj sipas Legjislacionit në fuqi.

Ortakët kanë të drejtë të eksportojnë fitimin jashtë shtetit në valutë, të eksportojë lëndë të parë, produkte dhe shërbime konform Legjislacionit Shqiptar.—

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe do të përballojë humbjet deri në kufirin e kontributit të themeluesve të saj në kapitalin themeltar.—

NENI- 5
AFATI- VULA

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar dhe fiton personalitetin e saj nga momenti i rregjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (ish-QKR) në Tiranë. Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtje "PEGASUS OIL TRADING " sh.p.k. Tiranë, Albania.—

NENI 6
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë në shoqëri.

Kapitali i Shoqërisë, në tërësi zotërohet nga Ortakët **Z. VINCENT , ARA FABRE** të cilët kanë formuar kapitalin fillestar të shoqërisë në vlerën prej **100.000 lekë -- (njëqind mijë)**, me nga 1 kuotë secili. **Z.VINCET , ARA FABRE zotëron 1 kuotë me vlerë nominale 100.000ALL** (nje qind mijë lekë) ose 100% të kapitalit të shoqërisë.Të gjithë kuotat e kapitalit themeltar janë të nënshkrueshme dhe të shlyeshme krejtësisht. Çdo kuote i takon e drejta e një vote.

NENI -7

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar.

NENI -8

Ortakët mund t'u shesin të tretëve kuotat e tyre të kapitalit pjesërisht ose tërësisht por pasi tua kenë ofruar për blerje ortakëve brenda shoqërisë me kushte jo më pak të favorshme nga ato që j'u ofrohen të tretëve. Oferta u komunikohet me shkrim ortakëve të cilët kanë të drejtën e parablerjes, e drejtë që duhet ta ushtrojnë brenda 30 ditëve nga data e komunikimit.

NENI- 9

Kapitali i shoqërisë do të përbehet nga kapitali themeltar, mjetet e xhiros dhe të tjera të nevojshme të luajtëshme apo të paluajtëshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë.

NENI 10

Heqja dorë nga shoqëria nuk e liron ortakun nga detyrimet e lindura me parë ndaj shoqërisë. Gjithashtu ai gëzon të gjitha të drejtat e lindura para largimit të tij.—

NENI 11
ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

Asambleja e ortakëve.



Administratori i Përgjithshëm/ Përfaqësuesi ligjor

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet si më poshtë.

NENI 12 ASAMBLEJA

Asambleja e ortakëve është organi më i lartë vendimor. Ajo mbledhet sa herë e shohin të arsyeshme ortakët me një quorum prej (60% e votave), por domosdoshmërisht për të miratuar bilancin vjetor të shoqërisë. Asambleja i merr vendimet me 50%+ 1 të votave të përgjithshme.

NENI 13

Asambleja vendos për bilancin vjetor, për ndryshimet në statut, shtimin ose pakësimin e kapitalit, për emërimin e organit administrativ, për drejtimet kryesore të veprimtarisë së shoqërisë, për pushimin apo ritjen e veprimtarisë së shoqërisë.—

NENI 14 ORGANI –ADMINISTRATIV

Administrator i Përgjithshëm i shoqërisë "PEGASUS OIL TRADING" sh.p.k. caktohet **ZJ. KRISTIANA ABOUD**, e bija e Salvator dhe Files , banuese ne tirane , me datelindje 17 Nentor 1991 dhe me numer ID J16117023K për një afat kohor 5 –vjeçare, nga data e regjistrimit të shoqërisë në Q.K.B (ish-QKR).

Administrator i Përgjithshëm ka të drejtë të administrojë pasurinë e shoqërisë dhe të kryejë veprimet bankare që kanë të bëjnë me llogarinë dhe veprimtarinë e shoqërisë. Ortakët e shoqërisë kanë të drejta e detyrime të barabarta ndaj shoqërisë e ligjeve.

NENI 15

Administrator i Përgjithshëm ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët për përmbushjen e aktivitetit të saj në përputhje me nenin 6 të këtij statuti.

Organi Administrativ (Administratori i Përgjithshëm) është kompetente për të:

- realizuar mbledhjen e asamblesë duke njoftuar ortakët me shkrim 15 ditë më parë;
- miratuar planet dhe bilancet periodike mujore dhe tre mujore;
- propozuar strukturën e aparatit të shoqërisë;
- marrë në punë persona të ndryshëm dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta duke lidhur kontrata pune, qirajë e veprime të tjera juridike në funksion të shoqërisë;
- propozuar rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve të ndryshme (të veçanta), ndarjen e fitimit, etj.
- përfaqësuar apo emëruar përfaqësues në çështje gjyqësore që mund të ketë shoqëria;

 4

- emëruar përfaqësues duke i deleguar të gjitha ose një pjesë të kompetencave të tij.—

NENI 16

KUSHTET EKONOMIKE

Shoqëria është pronare, përdoruese dhe disponuese e pasurisë së saj. Ajo vepron në regjistrin e pronës si çdo person tjetër juridik në Shqipëri, mund të blejë, të shesë, të japë në përdorim, të ngarkojë me barrë për detyrime ndaj të tretëve ose për kredi bankare, etj.

NENI 17

Shoqëria ka llogarinë e saj rrjedhëse, si dhe librin e saj të llogarive në bazë të kërkesave të ligjit për kontabilitetin e dispozitave të tjera fiskale. Transferimi i mjeteve monetare dhe transaksionet financiare do të kryhen në bazë të kriterëve të caktuar nga Banka e Shqipërisë.

NENI 18

Veprimet ekonomiko-financiare të shoqërisë nisin vitin e parë në momentin e regjistrimit në organet tatimore, ndërsa vite të tjera në Janar dhe mbyllen në 31 Dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo periudhe ushtrimore hartohet bilanci kontabël sipas ligjeve në fuqi. Bilancet periodike (muajore, tremujore e gjashtëmuajore) miratohen e nënshkruhen nga Administratori i Përgjithshëm e më pas ratifikohen në asamblenë e rradhës. Bilancet vjetore miratohen nga asambleja dhe nënshkruhen nga administratorja/ Përfaqësuesja Ligjore.—

NENI 19

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria i mbetet në përdorim ortakëve në përpjestim me kontributin e tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë, mbasi të jenë likuiduar të gjitha detyrimet e të jetë hequr fondi i rezervës ligjore, sipas vendimeve të asamblesë.

NENI 20

Nga fitimet e realizuara gjatë vitit financiar shoqëria pasi bën zbritjen e humbjeve të vitit të mëparshëm, lë mënjanë 5 % të fitimit me të cilin krijohet fondi rezervë i domosdoshëm derisa ky fond të arrijë masën 10 % të kapitalit themeltar.

NENI 21

MARRËDHËNIET E PUNËS

Marrëdhëniet e punës në këtë shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Për çëshjet që nuk parashikohen në to zbatohen dispozitat e Kodit të Punës në R.SII. Mosmarrëveshjet e punonjësve me shoqërinë do të zgjidhen në gjykatën shqiptare. Punonjësit e emëruar nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimit të realizuar nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj, nëse në kontratë nuk është parashikuar ndryshe. Për punën e kryer punonjësit marrin pagë siç është parashikuar në kontratë.

NENI -22

DISPOZITA TË VEÇANTA

Veprimtaria e shoqërisë pushon me vendim të asamblesë për shkaqet:

- veprimtaria rezulton negative
- pamundësi veprimi
- shpërndahet me vullnetin e ortakëve
- riorganizohet në një formë tjetër.

NENI 23

Bazuar edhe në nenet e sipërcituara të këtij statuti asambleja cakton një ose më shumë likujdatorë të cilët marrin në dorë drejtimin e shoqërisë duke kryer gjithë veprimet e likujdimit të saj, duke likujduar në radhë të parë detyrimet ndaj shtetit e më pas ndaj të tretëve. Në rastin e tepricës së kapitalit të shoqërisë me përfundimin e likujdimit, kjo i shpërndahet ortakëve, ndërsa në rastin e pamjaftueshmërisë së kapitalit ortakët janë të detyruar të derdhin kuotat e tyre deri në nivelin e kuotave të kapitalit themeltar.—

NENI 24

Mosmarrëveshjet midis ortakëve zgjidhen me pajtim, në të kundërt palët i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.—

NENI 25

SHNDËRRIMI, SHPËRNDARJA DHE PRISHJA E SHOQËRISË

Shndërrimi i shoqërisë "PEGASUS OIL TRADING " sh.p.k. në shoqëri të tipeve të tjera, kolektive ose në drejtim të thjeshtë, mund të bëhet me vendim të asamblesë së ortakëve.—

NENI 26

Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarë do shkakut si:

- Humbja e kapitalit të shoqërisë
- Pamundësi veprimi
- Me vendim të asamblesë të ortakëve
- Në këto raste pronari i shoqërisë vendos mbi mënyrën e likujdimit dhe cakton një ose më shumë likujdatorë duke ju përcaktuar dhe detyrat.—
- Administratori i Përgjithshëm dhe likujdatori janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë, përderisa ajo tu dorëzohet personave përkatës fizike e juridike duke u likujduar në radhë të parë detyrimet ndaj personave të tretë që ka shoqëria. Në rast se fondet disponibël, rezultojnë të pamjaftueshme për shlyerjen e detyrimeve të Shoqërisë likujdatori mund t'i kërkojë ortakëve themelues të shoqërisë që të derdhin tërësisht kuotat që i takojnë atij.—

NENI- 27

DISPOZITA TË -FUNDIT

Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me nenet e këtij statuti dhe aktit bashkëlidhur dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit Tiranë.

NENI - 28

Për sa nuk është shprehur në këtë statut i referohet plotësimeve që do të bëjë asambleja si dhe ligjeve të veçanta në të cilat është referuar hartimi i këtij statuti. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij statuti bëhen në të njëjtën mënyrë e procedurë me të cilën është hartuar vetë statuti.

NENI- 29

Ky statut u përpilua në prani të ortakëve duke shprehur vullnetin e tyre të plotë e të lirë. Ai u përpilua në katër kopje me fuqi të barabartë secila për t'u depozituar në QKR dhe për t'u shpërndarë në organet kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.—

ORTAKËT

Z. VINCENT,ARA FABRE

ADMINISTRATORI

ZJ. KRISTIANA ABOUD

Kristiana Aboud

**AKT THEMELIMI
E SHOQËRISË TREGTARE
"PEGASUS OIL TRADING" sh.p.k.**

Në bazë të ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE" dhe atij Nr. 9723, datë 03.05.2007 "PËR QENDRËN KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT", me vullnetin e tyre të lirë:

Në Tiranë më datë 21 Maj 2020 (dymijë e njezet) ditën e Enjete para meje u paraqitën personalisht:

Z.VINCENT,ARA FABRE i biri i Roger dhe Claire lindur në Monte Karlo, Monako ,më 05.05.1971 banues në Monako, Rr 8 Gastaldi 98000MC , i identifikuar me Pasaportën Franceze me Nr. 11CF99964

I lartpërmenduri është madhorë me zotësi të plotë juridike për të vepruar të cilët deklaruan se nuk e kuptojnë gjuhën shqipe dhe asistohen prej meje KRISTIANA ABOUD në gjuhën angleze dhe me vullnetin e tyre të lirë e të plotë kanë vendosur të krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin.

Të lartpërmendurit janë madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar të cilët deklaruan se me vullnetin e tyre të lirë e të plotë kanë vendosur të shpallin si vijon:

NENI 1

Formohet shoqëria tregtare e emërtuar "**PEGASUS OIL TRADING** " sh.p.k. me ortakë themelues **Z. VINCENT, ARA FABRE**

Shoqëria do t'i nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do t'i nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit që do të miratohet nga ortakët themelues.

EMËRTIMI : "**PEGASUS OIL TRADING** " sh.p.k

SELIA : Rruga "**FATMIR HOXHA , PALLATI ETC KULLA A KATI 6/3.**"—

Shoqëria do të jetë person juridik me regjistrimin në QKB sipas nenit 22 të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" dhe në bazë të Ligjit Nr 9901 të datës 14.04.2008 "PËR TREGËTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE". Shoqëria do të gëzojë të gjithë të drejtat si person juridik dhe do të fillojë veprimtarinë e saj nga data e regjistrimit në QKR.—

NENI 2

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe do të përballojë humbje deri në kufirin e kontributit të themeluesve të saj në kapitalin themeltar.—

NENI 3

Shoqëria e ka selinë e saj kryesore në Tiranë në adresën: : Tiranë, Rruga "Fatmir Hoxha,Pallati ETC kulla A apartamenti 6/3, Tiranë, Albania. Ajo mund të çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjensi operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe me miratim të organeve kompetente edhe jashtë vendit.

NENI 4

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar dhe fiton personalitetin e saj ligjor nga momenti i rregjistrimit në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit Tiranë.—

NENI 5

QËLLIMI I SHOQËRISË

Objekti i veprimtarisë së saj do të jetë:

Sherbime ndermjetesimi ne sektorin e karburanteve(duke perfshire por jo kufizuar ne produkte te papurpunuara-nafta dhe ato te perpunuara ne rafineri),ndermjet shitesve , furnizuesve dhe bleresve, brenda dhe jashte vendit.

Sherbime ndermjetesimi,asistence te pandeprere dhe konsulence ne fushen e tregut te gazit te lengshem; Nenprodukte te tjera te lengshme te tilla si: karburanteve benzol,toluol,ksilol,solven,white spirit;Gazoil ;Vajgur ndricues ; Lende djegese kerosene;Lende djegese per perdorim termik civil dhe/ose industrial; Vajra per te gjitha llojet e mjeteve; Bitumen ; Mazut, dhe cdo produkt tjetër qe nuk eshte permendur ketu por ben pjese ne produktek e naftes dhe gazit.

Sherbime ndermjetesimi ndermjet prodhuesve dhe perpunuesve te karburanteve (te tilla si rafineri naftë, qe ushtrojne veprimtari te perpunimit te naftes bruto;naftsjelles ,qe ushtrojne veprimtarine e transportimit,etj) me bleresit me shumice te produkteve te siperpermendura.

Zhvillimin e projektevete ndryshme ne fushen e gazit dhe hidrokarbureve brenda dhe jashte vendit ne lidhje me impiante perpunimi ,naftsjelles,transport te naftes dhe gazit.

Ofrim Sherbimesh , Asistence teknike dhe menaxhimi organizativ dhe tregtar te ndermarrjeveqe veprojn ne sektorin e mesiperm.

Dhe ne pergjithesi cdo veprim ne natyre juridike dhe financjare,industriale ,publike ose tregtare ,prona te palujtshme ose te luajtshme ,te gjitha keto te cilat lidhen me objektin e shoqerise ose me te tjera te cilat jan te ngjashme ose te peraferta dhe ndihmojn direkt ose indirekt ne objektin e shoqerise, ne shtrirjen dhe zhvillimin e saj.

Si objekt te veprimtarise se saj shoqeria do te kete edhe kryerjen e cdo operacioni ekonomik dhe juridik te lejuar nga legjislacioni Shqiptar , ne perputhje me objektin e veprimtarise se saj dhe qe kane rendesi per te ardhmen e shoqerise.

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë në shoqëri.

Kapitali i Shoqërisë, në tërësi zotërohet nga Ortakët **Z. VINCENT , ARA FABRE** të cilët kanë formuar kapitalin fillestar të shoqërisë në vlerën prej **100.000 lekë -- (njëqind mijë)**, me nga 1 kuotë secili. **Z.VINCET , ARA FABRE zotëron 1 kuotë me vlerë nominale 100.000All.** (nje qind mijë lekë) ose 100% të kapitalit të shoqërisë.Të gjithë kuotat e kapitalit themeltar janë të nënshkrueshme dhe të shlyeshme krejtësisht. Çdo kuote i takon e drejta e një vote.

NENI -7

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar.

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve themelues, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar.

NENI 8

Ortakët mund t'u shesin të tretëve kuotat e tyre të kapitalit pjesërisht ose tërësisht por pasi tua kenë ofruar për blerje ortakëve brenda shoqërisë me kushte jo më pak të favorshme nga ato që iu ofrohen të tretëve.Oferta u komunikohet me shkrim ortakëve të cilët kanë të drejtën e parablerjes, e drejtë që duhet ta ushtrojnë brenda 30 ditëve nga data e komunikimit.

NENI 9

Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtje "PEGASUS OIL TRADING " sh.p.k Tiranë, Albania.—

NENI 10

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

Asambleja e ortakëve dhe Administratori i Përgjithshëm

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet si më poshtë.

NENI 11

Administrator i Përgjithshëm i shoqërisë "**PEGASUS OIL TRADING "** sh.p.k caktohet **ZJ. KRISTIANA ABOUD** , për një afat kohor 5 -vjeçar, nga data e regjistrimit të shoqërisë në Q.K.B (ish-QKR).



Administratori i Përgjithshëm ka të drejtë të administrojë pasurinë e shoqërisë dhe të kryejë veprimet bankare që kanë të bëjnë me llogarinë dhe veprimtarinë e shoqërisë. Ortakët e shoqërisë kanë të drejta e detyrime të barabarta ndaj shoqërisë e ligjeve.

NENI 12

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve themelues të shoqërisë në propocion me kuotat e tyre në kapitalin fillestar.

NENI 13

Ortakët dhe administratori kanë të drejtë të caktojnë financier, likuidator për problemet e shoqërisë, si dhe të pajtojnë persona të tjerë si ortakë. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiarë të tre-mujorit, të 6-mujorit dhe vjetor për aktivitetin e kryer të shoqërisë.

NENI 14

Transferimi i mjeteve monetare dhe transaksionet financiare do të kryhen në bazë të kriterëve të caktuara nga Banka e Shqipërisë. Shoqëria ka llogarinë e saj rrjedhese dhe librin e saj të llogarive në bazë të kërkesave të ligjit për kontabilitetin e dispozitave të tjera fiskale.

NENI 15

Ky akt u përpilua në prani të ortakëve duke shprehur vullnetin e tyre të plotë e të lirë. Akti u përpilua në katër kopje me fuqi të barabartë secila, për t'u depozituar në QKR e për t'u shpërndarë në organet kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin e shoqërisë.

ORTAKËT

Z. VINCENT , ARA FABRE



A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Z. Vincent, Ara Fabre', written over a horizontal line.

ADMINISTRATORI

ZJ. KRISTIANA ABOUD



A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Kristiana Aboud', written over a horizontal line.